

VIZIONI

Vizioni i projektit është arritja e ndryshimeve në sistem, duke zhvilluar partneritete dhe duke nxitur akterët ekzistues të tregut të marrin një rol proaktiv në ofrimin e informatave dhe shërbimeve për punësim si dhe ofrimin e programeve aftësuese, me qëllim rritjen e mundësive për punësim dhe gjenerim të të ardhurave.



REZULTATET DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTT

Projekti do të implementohet nga një ekip prej pesë punonjësve vendor të projektit, si dhe akterë dhe partnerë lokal. Partneriteti lokal është i një rëndësie madhore për të siguruar se janë arritur rezultatet e projektit dhe janë të qëndrueshme edhe pas intervenimeve të APR.

REZULTATI 1: APR do të punoj me akterët ekzistues lokal, institucionet lokale, për të përmirësuar shërbimet e punësimi, ofrimin e informatave dhe programeve të aftësimi për të rinjtë e papunë në zonat rurale, veçanërisht për gratë dhe minoritet.

REZULTATI 2: Projekti synon të integroj më mirë prodhuesit e vegjël dhe bizneset në sektorët e përzgjedhur, për të përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë me qëllim gjenerimin e të ardhurave. Sektorët e përzgjedhur janë: blegtori, bletari, produkte pyjore jo-drusore dhe pemëtari.

REZULTATI 3: APR do të nxis përmirësimin e performancës dhe rritjen e bizneseve lokale me synim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, përmes investimit në trajnim dhe aftësim jo formal të punëtorëve ekzistues dhe të rinj.

Kohëzgjatja e projektit	2016 – 2018
Shtrirja e projektit:	Bjeshkët e Sharrit dhe Juglindja e Kosovës
Përfituesit:	Të rinjtë e papunë, gratë dhe minoritetet, ekonomitë familjare rurale si prodhues në zinxhirin furnizues apo të punësuarit e bizneseve lokale dhe ofruesit e trajnimeve



Për të mësuar më shumë rreth projektit tonë, ju lutemi na vizitoni në: www.helvetas-ks.org

Nazim Gafurri str. 33
Po Box no.2
10000 Pristina, Kosovo

Tel: +381(0) 38 51 77 15
Tel: +381(0) 38 51 66 44
Fax: +381(0) 38 51 88 33
Email: s4re@helvetas.org



APR Aftësitë për Punësim Rural





ZONAT E PROJEKTT DHE PËRFITUESIT E TYRE

APR II vazhdon të fokusohet në komunat e **Bjeshkëve të Sharrit** dhe në **Juglindje të Kosovës**, duke synuar komunat ekzistuese të Kamenicës, Dragashit, Shtërpcës dhe Novobërdës dhe shtrirjen e fushëveprimit në tetë komuna shtesë në këto dy regjione.

Numri i përgjithshëm i përfituesve do të jetë 6,000 të rinj të papunë, gra dhe minoritete, ekonomi familjare rurale si prodhues në zinxhirin furnizues apo punëtorë të bizneseve lokale si dhe ofrues të trajnimeve.

Femra dhe meshkuj të ri prej moshës 15-35 (synimi për femra do të jetë 50%), si dhe grupe të minoriteteve etnike (synimi do të jetë 25%) të cilët janë në mesin e grupeve më të pa favorizuara në këto regjione dhe janë grupi kryesor i synuar për intervenimet e APR, duke promovuar përfshirjen gjinore dhe sociale.

NDIKIMI I PROJEKTT

Fokusi strategjik i APR në fazën e dytë është në thellimin dhe zgjerimin e ndikimit për të arritur shkallë të gjërë dhe qëndrueshmëri. Duke u mbështetur në përvojat dhe mësimet e mësuara nga faza e parë, projekti do të kërkojë të transferoj njohuritë dhe përvojat tek partnerët lokal mbi modele dhe zgjidhje të suksesshme për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve, në mënyrë që ata të vazhdojnë të ofrojnë shërbime për të rinjtë dhe bizneset, dhe kështu të zëvendësojë projektin në ofrimin e shkathtësive dhe kapaciteteve themelore. Projekti synon të përsëris apo përshtat në komunat tjera shtesë të dy regjioneve të përzgjedhura modelet dhe zgjidhjet e suksesshme të implementuara në katër komunat fillestare.



PASQYRA E PROJEKTT

Qëllimi i përgjithshëm i APR është përmirësimi i mundësive të gjenerimit të të ardhurave dhe punësimit të të rinjve, në veçanti grave dhe minoriteteve, si dhe familjet rurale në komunat e bjeshkëve të Sharrit dhe Kosovës juglindore.

Në mënyrë që të arrihet qasje e përmirësuar për gjenerim të të ardhurave dhe mundësi punësimi, qasja e integruar e APR kërkon të përmirësojë punësueshmërinë e të rinjve përmes shkathtësive më të duhura dhe të orientuara nga tregu, të lehtësojë integrimin

më të mirë të prodhuesve dhe bizneseve të vogla lokale në zinxhirin e furnizimit, dhe të nxis një konkurrueshmëri të bizneseve përmes investimit në arsimin dhe trajnimin jo formal.

